DEKRET
Nr. 460, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1
Dhënien e dekoratës "Kalorës i Urdhrit të Lisit Akademik"
zonjës Liljana Luani

"Në vlerësim të kontributit mjaft të spikatur dhe të qëndrueshëm në arsim dhe edukim, si edhe për angazhimin shembullor në mbrojtje të të drejtave themelore të fëmijëve dhe në zhvillimin e shëndoshë fizik, psikologjik dhe etik të rinisë shqiptare në territore dhe në periudha të vështira të shenjuara nga dukuria e hidhur e gjakmarrjes".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj